

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- “Suporte TIK”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shërbimet e teknologjisë së informacionit – 7222300-0;
- Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit – 72267100-0.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas shtojcës 8, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Si dëshmi për përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori Ekonomik pjesmarres duhet të jete i certifikuar sipas ISO 9001. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesit duhet të paraqesin Certifikatën ISO 9001 - 2015 e cila duhet të jete për te njejtën fushe me kategorinë dhe specifikën e produkteve/shërbimeve që prokurohen. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qenë se zërat pjesë e prokurimit janë teper të rëndësishme për sigurinë dhe vijueshmërinë e punës të sistemeve kritike në APD duhet që subjektet zbatuese të kontratës të jenë të pajisura me këto certifikime.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kërkohen. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë.

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë Autorizim nga prodhuesi për shitjen e shërbimit të garancisë/suportit të pajisjeve dhe të licencave, të përfshira në listën e suporteve. Autorizimet duhet të lëshohen nga prodhuesit e sistemeve ose distributori i autorizuar: (1) Cisco; (2) HP; (3) Oracle; (4) VMware ose ekuivalente me to. Autorizimet duhet të lëshohen në drejtim të APD dhe në to duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për verifikimin e tyre.

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për territorin e Shqipërisë për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton që produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve në kushtet e garancisë dhe pas saj.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.4 Ofertuesi duhet të provojë që ka një grup të avancuar aftësish për të plotësuar nevojën e Autoritetit Kontraktor për siguri të lartë nga sulmet e ndryshme dhe komplekse në aspektin e sigurisë së sistemeve. Kjo të provohet nëpërmjet certifikimit që Ofertuesi duhet të ketë në fushën e sistemeve të sigurisë së informacionit. Certifikata duhet të jetë lëshuar nga prodhues ndërkombetarë të sistemeve të sigurisë.

Argumentimi:

Duke qenë se zërat e kerkuara në prokurim përfshijnë sisteme që lidhen direkt me sigurinë si edhe nisur nga fakti që AK është një nga pikat kryesore që lidhen me sigurinë kombëtare kërkohet që operatorët ekonomik të interesuar të jenë të specializuar dhe certifikuar për fushën e sigurisë së informacionit.

2.3.5 Ofertuesi duhet te ketë ne stafin e tij minimalisht, personelin e mëposhtëm:

- 1 (një) person te certifikuar për sigurinë e informacionit;

Argumentimi:

Eshte kerkuar ky kriter pasi eshte shume e rendesishme qe personi qe do te ndjeke suportin e nje pjese te sistemeve pjese e procedures te kete certifikate per sigurine e informacionit.

- 1 (një) person te certifikuar për pajisje server;

Argumentimi:

Eshte kerkuar ky kriter pasi nje pjese e rendesishme e zerave ne kete procedure kane te bejne me server-at qe aktualisht APD ka ngritur sistemet te cilat sherbejne per funksionimin normal te punes.

- 1 (një) person te certifikuar per sistem virtualizimi (Vmware ose ekuivalent);

Argumentimi:

Eshte kerkuar ky kriter pasi nga lista e zerave qe prokurohen perfshihet edhe rinovimi suportit per platformen ne te cilen jane ngritur server-at virtual. Per kete arsye personi qe do te suportojte per kete infrastrukture duhet te kete informacionin e nevojshem te shoqeruar me certifikim.

- 1 (një) person te certifikuar ne rrjete ne nivel profesional;

Argumentimi:

Eshte kerkuar ky kriter pasi nga lista e zerave qe prokurohen perfshihen pajisje qe kane te bejne me rrjetin e APD. Per kete arsye personi qe do te suportojte per kete infrastrukture duhet te kete informacionin e nevojshem te shoqeruar me certifikim. Ne nivelin professional gje qe do te garantoj kryerjen me cilesi te rinovimit dhe suportit.

- 1 (një) person te specializuar per sistemet Oracle ose ekuivalent;

Argumentimi:

Eshte kerkuar ky kriter pasi nje pjese e rendesishme e zerave ne kete procedure kane te bejne me sistemin Oracle qe aktualisht APD ka ne perdorim dhe qe perben nje pjese te rendesishme te punes ne APD. Nevojitet qe minimalisht 1 person te jete I certifikuar ne kete teknologji per arsye qe personi qe do te suportojte per kete teknologji te kete informacionin e duhur dhe te shoqeruar me certifikimin perkates.

- 1 (një) person te specializuar ne sistemet e kontrollit te hyrjeve (Skidata ose ekuivalent).

Argumentimi:

Eshte kerkuar ky kriter pasi eshte shume e rendesishme qe personi qe do te ndjeke suportin e sistemeve te akses kontroll te jete I certifikuar ne keto teknologji. Sistemet e akses kontroll per njerez dhe mjete jane sisteme qe lidhen direkt me sigurine e APD.

Per te gjithë stafin e mesiperm Ofertuesi duhet te paraqesë certifikatat profesionale përkatëse.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b, c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht, sipas nënpikave, respektivisht:

a) Gjykohet se është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij një person të certifikuar për sigurinë e informacionit. Kjo për të siguruar që OE do të plotësojë kërkesat e AK për të qenë i sigurt ndaj sulmeve dhe kërcënimeve kibernetike që ndodhin kohë e sotme. Një pjesë e konsiderueshme e sistemeve pjesë e prokurimit lidhen direkt me sigurinë dhe vijueshmërinë e punës së AK.

b) Gjykohet se është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij një person të certifikuar për pajisje server duke qenë se pjesë e prokurimit është edhe rinovimi i suportit për pajisje server. Do të jetë e nevojshme nevoja për mbështetje teknike gjatë proceseve të rinovimit të suportit, të mbajtjes së marrëdhënies me prodhuesin si edhe në ofrimin e zgjidhjeve për situata problematikash që mund të ndodhin në këto pajisje ndaj stafit të certifikuar do të sigurojë AK që rinovimet dhe problematikat do të zgjidhen në kohë dhe me profesionalizem.

c) Gjykohet si i nevojshëm që OE të ketë në stafin e tij një person të certifikuar në teknologjinë e virtualizimit VMware pasi mbi këto teknologji janë ngritur shumë nga shërbimet që aktualisht AK ka në përdorim. Për të garantuar rinovimin me sukses të suportit, mbajtjen e marrëdhënies me prodhuesin në rast problematikash kërkohet që OE të ketë një person të specializuar në këto teknologji.

d) Gjykohet i nevojshëm të ketë në stafin e tij një person të certifikuar për pajisje rrjeti në nivelin profesional duke qenë se pjesë e prokurimit janë edhe pajisjet e rrjetit. Do të jetë e nevojshme nevoja për mbështetje teknike gjatë proceseve të rinovimit të suportit, të mbajtjes së marrëdhënies me prodhuesin si edhe në ofrimin e zgjidhjeve për situata problematikash që mund të ndodhin në këto pajisje ndaj stafit të certifikuar do të sigurojë AK që rinovimet dhe problematikat do të zgjidhen në kohë dhe me profesionalizem.

e) Gjykohet se është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij një person të certifikuar për teknologjinë Oracle duke qenë se pjesë e prokurimit është edhe rinovimi i suportit për sistemin Oracle. Si një nga sistemet më të rëndësishme pjesë e këtij prokurimi është e nevojshme mbështetja teknike gjatë proceseve të rinovimit të suportit, të mbajtjes së marrëdhënies me prodhuesin si edhe në ofrimin e zgjidhjeve për situata problematikash që mund të ndodhin në këto pajisje ndaj stafit i

certifikuar do të sigurojnë AK që rinovimet dhe problematikat do të zgjidhen në kohë dhe me profesionalizëm.

f) Gjykohet si i nevojshëm që OE të ketë në stafin e tij një person të certifikuar në sistemet e aksesit kontroll që AK ka aktualisht në përdorim, SKIDATA pasi kjo teknologji kanë të bëjnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë me sigurinë e AK ndaj dhe operimit në çdo kohë i tyre është i rëndësishëm së lartë. Për të garantuar rinovimin me sukses të suportit, mbajtjen e marrëdhënieve me prodhuesin në rast problematikash kërkohet që OE të ketë një person të specializuar në këto teknologji.

2.3.6 Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmojë nga ofertuesit nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST, duke përcaktuar edhe dokumentet që duhet të paraqiten nga ofertuesi fitues para publikimit të njoftimit të fituesit, për të dëshmuar disponimin e tyre.

Argumentimi:

Sistemet pjesë e kësaj procedure duke qenë se janë sisteme tepër të rëndësishme për vijueshmërinë e punës në APD si edhe lidhen direkt me sigurinë e APD, kërkohet që OE të ketë në stafin e vet punonjës me eksperiencë dhe të kualifikuar për këto sisteme.

Garancia dhe afati levrimit

Garancia për pajisjet dhe licencat të sistemeve të informacionit pjesë e procedurës, është minimalisht 1 (një) vit nga mbarimi i shërbimit paraardhës të garancisë. Operatori Ekonomik ka 30 ditë kohë nga momenti i lidhjes së kontratës për rinovimin e suporteve të zerave që do të prokurohen. Vlera e garancisë së kontratës së prokurimit do të shërbente si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve, sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit të shërbimeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termit e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose

produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në dokumentet mbi Specifikimet Teknike, bashkëlidhur dokumenteve standarte të tenderit, janë përcaktuar, duke i detajuar të gjithë pikat dhe kriteret e specifikimeve teknike, për kontratën e prokurimit me objekt “Suporte TIK”.

KOMISIONI: